



BANKA E SHQIPËRISË

**“NDIKIMI I KRIPTOMONEDHAVE
NË STABILITETIN FINANCIAR DHE
CIKLIN FINANCIAR”**

**Natasha Ahmetaj
Bledar Hoda
Livia Nikolla
Arisa Goxhaj (Saqe)**

MATERIAL PËR DISKUTIM

Natasha Ahmetaj

Zëvendësguvernatore e Dytë, Banka e Shqipërisë, e-mail: nahmetaj@bankofalbania.org

Bledar Hoda

Departamenti i Kerkimeve, Banka e Shqipërisë, e-mail: bhoda@bankofalbania.org

Livia Nikolla

Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë, e-mail: lnikolla@bankofalbania.org

Arisa Goxhaj (Saqe)

Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë, e-mail: asaqe@bankofalbania.org

***Shënim:** Për arsye të terminologjisë së përdorur, studimi i plotë është në gjuhën angleze.
Në këtë material do gjeni një përmbledhje ekzekutive të tij.*

© Banka e Shqipërisë, 2022

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky material diskutimi parashtron rreziqet e reja që mund të çënojnë stabilitetin financiar në rast se ekosistemi i kriptomonedhave do të marrë një peshë materiale në sistemin financiar, si edhe ndikimet në ecurinë e ciklit financiar. Fillimisht, krahasohen monedhat digjitale të tre kategorive të ndryshme: kriptomonedhat me çmim të luhatshëm, kriptomonedhat me çmim fiks si stablecoin dhe paranë elektronike të bankave qendrore (PEBQ) në tregun e monedhave digjitale. Krahasimi i tyre është bërë në bazë të kriterëve relative bazike si: (i) lehtësia e kryerjes së transaksioneve, (ii) luhatshmëria e çmimit, (iii) mundësia e dështimit të tyre, dhe (iv) lehtësia e aksesit të secilës forme të parasë për të gjetur atë me përhapje të gjerë në publik. Mes dy alternativave private, stablecoin kanë një perspektivë për të gjetur përdorim më të gjerë në publik. Megjithatë, bazuar në rishikimin e literaturës, rezulton se stablecoin mbart rreziqe të ngjashme me ato të një tregu financiar tradicional të parregulluar dhe paraqet një sfidë për autoritetet kombëtare. Në veçanti, nënvizohet se përhapja në shkallë të gjerë e një ekosistemi të stablecoin mund të sfidojë ndërmjetësimin bankar e financiar në tregjet tradicionale financiare, të rrisë mundësinë e panikut bankar dhe fenomenit të tërheqjes së menjëhershme të fondeve nga bankat, si dhe të përshkallëzojë transmetimin e goditjeve dhe cikleve financiare midis ekonomive të ndryshme, duke e bërë më të vështirë për politikëbërësit të kufizojnë dhe luftojnë pasojat negative në ekonomi, sidomos gjatë periudhave të krizës. Rreziqet që vijnë nga përdorimi më i gjerë i produkteve dhe shërbimeve FinTek (teknologjisë financiare) janë gjithashtu një burim paqëndrueshmërie për sistemin financiar, sidomos kur aktorët financiarë ekspozojnë bilancet e tyre ndaj këtyre produkteve.